

Në bazë të nenit 38, paragrafi 1, pika 2, e në lidhje me nenin 59 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale ("Fl. zyr. MZ", nr. 2/2018 dhe 34/2019), nenin 42, paragrafi 1, pika 2, e në lidhje me nenin 86 të Statutit të Komunës së Ulqinit ("Fl. zyr. MZ – dispozitat e komunës", nr. 5/07, 9/09 dhe 16/11), Kuvendi i Komunës së Ulqinit në mbledhjen e mbajtur, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2019 ka nxjerr

## V E N D I M

**për dhënien e pëlqimit në Vendimin Kryetarit të Komunës nr. 01 – 1299/19 të datës 12. 08. 2019 për shfuqizimin e Vendimit për përcaktimin e lartësisë së pagesës së njehershme të nëpunësve dhe zyrtarëve lokalë të Komunës së Ulqinit**

### Neni 1

Jepet pëlqimi në Vendimin e Kryetarit të Komunës nr. 01 – 1299/19 të datës 12. 08. 2019 për shfuqizimin e Vendimit për përcaktimin e lartësisë së pagesës së njehershme të nëpunësve dhe zyrtarëve lokalë të Komunës së Ulqinit ("Fl. zyr. MZ – dispozitat e komunës", nr. 48/15).

### Neni 2

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e tetë pas botimit në "Fletoren zyrtare të Malit të Zi – dispozitat e komunës".

Numër: 02 - \_\_\_\_\_  
Ulqin, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2019

KRYETARI I KUVENDIT  
Ilir Çapuni

## Arsyetim

Baza juridike për nxjerrjen e këtij Vendimi është në nenin 58, paragrafi 1, pika 3 dhe nenin 59 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale dhe nenin 83, paragrafi 1, pika 3 dhe nenin 86 të Statutit të Komunës së Ulqinit, me të cilët është paraparë obligimi i Kryetarit të Komunës që të kujdeset dhe është përgjegjës për zbatimin e ligjit, dispozitave të tjera dhe akteve të përgjithshme, Planin strategjik të zhvillimit të Komunës dhe planeve dhe programeve të tjera zhvillimore, si dhe për zbatimin e dokumenteve strategjike me rëndësi shtetërore dhe e drejta e Kryetarit të Komunës që perkohësisht të nxjerrë akte nga kompetencat e Kuvendit, nëse Kuvendi nuk ka mundësi që të mbledhet me obligimin që atë t'ia parashtrojë në konfirmim Kuvendit në mbledhjen e parë të radhës.

**Arseja e nxjerrjes** është Vendimi i Qeverisë së Malit të Zi për pagesën e njëhershme në rastin e pushimit të marrëdhënies së punës me marrëveshje të punësuarëve në sektorin publik, e me qëllim të zbatimit të planit të optimizimit të administratës publike në pajtim me Përfundimet e Qeverisë dhe zvogëlimin e shpenzimeve të administratës.

SEKRETARIATI PËR ADMINISTRATË  
DHE VEPRIMTARI SHOQËRORE

Në bazë të nenit 58, paragrafi 1, pika 3 dhe nenit 59 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale ("Fl. zyr. MZ", nr. 2/2018 dhe 34/2019), nenin 33, 35 të Ligjit për të ardhurat e të punësuarëve në sektorin publik ("Fl. zyr. MZ", nr. 16/16, 21/17, 42/17, 12/18, 42/18 dhe 34/19) dhe nenit 83, paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Ulqinit ("Fl. zyr. MZ – dispozitat e komunës", nr. 5/07, 9/09 dhe 16/11), Kryetari i Komunës nxjerr

## **V E N D I M**

**sër shfuqizimin e Vendimit për përcaktimin e pagesës së njëhershme të nëpunësve dhe zyrtarëve lokalë të Komunës së Ulqinit ("Fl. zyr. MZ – dispozitat e komunës", nr. 48/15)**

### **Neni 1**

Shfuqizohet Vendimi për përcaktimin e pagesës së njëhershme të nëpunësve dhe zyrtarëve lokalë të Komunës së Ulqinit ("Fl. zyr. MZ – dispozitat e komunës", nr. 48/15).

### **Neni 2**

Ky Vendim do t'i paraqitet për konfirmim Kuvendit të Komunës në mbledhjen e parë të radhës.

### **Neni 3**

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e publikimit në faqen e internetit dhe në tabelën e shpalljeve të Komunës.

Numër: 01 – 1290/19  
Ulqin, më 12. 08. 2019

**KRYETARI**  
Loro Nrekiq

### Arsyetim

**Baza juridike** për nxjerrjen e këtij Vendimi është në nenin 58, paragrafi 1, pika 3 dhe nenin 59 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale dhe nenin 83, pragrafi 1, pika 3 dhe nenin 86 të Statutit të Komunës së Ulqinit, me të cilët është paraparë obligimi i Kryetarit të Komunës që të kujdeset dhe është përgjegjës për zbatimin e ligjit, dispozitave të tjera dhe akteve të përgjithshme, Planin strategjik të zhvillimit të Komunës dhe planeve dhe programeve të tjera zhvillimore, si dhe për zbatimin e dokumenteve stratejike me rëndësi shtetërore dhe e drejta e Kryetarit të Komunës që përkohësisht të nxjerrë akte nga kompetencat e Kuvendit, nëse Kuvendi nuk ka mundësi që të mblidhet me obligimin që atë t'ia parashtrijë në konfirmim Kuvendit në mbledhjen e parë të radhës.

**Arsyeja e nxjerrjes** është Vendimi i Qeverisë së Malit të Zi për pagesën e njëhershme në rastin e pushimit të marrëdhënies së punës me marrëveshje të punësuarëve në sektorin publik, e me qëllim të zbatimit të planit të optimizimit të administratës publike në pajtim me Përfundimet e Qeverisë dhe zvogëlimin e shpenzimeve të administratës.

SEKRETARIATI PËR ADMINISTRATË  
DHE VEPRIMTARI SHOQËRORE